



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:015254

Datë: 03.08.2023

Numri i dokumentit: 04553304

C-IV.-14-1169

Ankuesi:

L Q K. Gjilan.

Kundër

Pala kundërshtare:

**N.SH “Morava e Binçës”, e përfaqësuar nga
Agjencia Kosovare e Privatizimit, lagja Lakrishtë rruga “Dritan Hoxha” nr. 55, Prishtinë.**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Shkelzen Sylaj, me dt.03 gusht 2023, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET ankesa si e pabazuar dhe VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit nr.GJI037-1410, dt. 18 shtator 2013, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**
- II. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 26 shkurt 2014, ankuesi parashtroj ankesë - kërkesë për rishqyrtimin e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit nr.GJI037-1410, dt. 18 shtator 2013, me të cilin i ishte refuzuar kërkesa për kompensim të tri pagave të pa paguara në shumë prej 750.00 € nga N.SH “Morava e Binçës” (në likuidim). Ankuesi pohoi se AKP ka bërë shkelje të dispozitave ligjore me rastin e vendosjes dhe se marrëdhënia e punës i është ndërprerë nga e njëjta. Bashkë me ankesën ankuesi i ka bashkëngjitur: Kopjen e vendimit të atakuar, Parashtresën e AKP dt.07.03.2011, Vërtetimin nr.374, dt.25.02.2011, Vendimin nr.760/3 dt.03.12.2003, Njoftimin nr.0400/IN dt.08.03.2011, Njoftimi nr.0428/2011 dt.14.03.2011 dhe një kopje të padisë SCC-11/98 dt.17.03.2011.

Me 08 mars 2016, e paditura në mbrojtjen e saj të parashtruar kundër ankesës, pohoi se AL ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht.

E paditura pohoi se kërkesa ka të bëjë me tri pagat e fundit të pa paguara nga NSH “Morava e Binçës”. Ka shtuar se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar, sipas të cilit pagesa e shumës së pagës apo rrogës apo ndonjë kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të parashkruhet për tri vjet, nga koha kur punëdhënësi nuk e ka përmbushur obligimin që rrjedh nga marrëdhënia e punës bazuar në nenin 36 par.2 pika 1 e Ligjit nr.04/L-034 dhe nenin 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar. I ka kërkuar gjykatës që të refuzoj ankesën si të pa pranueshme dhe të pa bazuar.

Me 31 mars 2016, ankuesi paraqiti përgjigje në mbrojtjen e të paditurës duke deklaruar se të gjitha shkresat e tij drejtuar AKP dhe DHPGJS-së janë në pajtim me ligjin. Me aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjilan C.nr.458/2009 dt.01.12.2012 këto paga janë vërtetuar.

Me 28 prill 2016, e paditura ka paraqitur kundërpërgjigje në përgjigjen e ankuesit, ku ka deklaruar se e kundërshton si ekzistencën ashtu edhe lartësinë e detyrimit të pretenduar dhe thekson rregullin bazik se në procedurë Kontestimore sipas të cilit ankuesi e ka detyrimin dhe barrën e provës duke ju referuara nenit 7 të LPK-së dhe nenit 23 të Ligjit të Dhomës së Posaçme. Ka shtuar se ankuesi nuk ka paraqitur asnjë dëshmi që do të mbështeste pretendimi e tij ankimore.

Arsyetimi ligjor

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe konstaton si në vijim.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se *“pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese)”*, ndërsa pika 3 parasheh se *“pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë”*.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen

faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Kërkesa e ankuesit që ka të bëjë me tre pagat e pa paguara në shumë prej 750.00 €, të cilat pretendohet të mos jenë paguar nga ana e N.Sh-së. Neni 40 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP parasheh prioritetin e kërkesave dhe interesave që duhet të përmbushen në procedurë të likuidimit, ndërsa pika 1.6.1 e po të njëjtit nen, parasheh pagesën e kërkesave për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto.

Gjykata gjen se kërkesa është e pabazuar për faktin se Shtojca e Ligjit për AKP-në neni 40, paragrafi 1.6.1 i referohet vetëm prioritetit të tri (3) pagave të fundit të papaguara. Prioriteti i lartë megjithatë nuk ia njeh automatikisht të drejtën e punëtorit për tri pagat por i jep prioritet në mesin e borxheve të tri pagave të fundit të cilat mund të kenë mbetur pa u paguar. Në çdo rast, një kërkesë e tillë duhet të jetë e mbështetur me prova, me anë të së cilave do të vërtetohej fakti se N.SH i ka mbetur borxh ankuesit pagat e kërkuara.

Deri sa e paditura e ka kundërshtuar detyrimin e N.SH-së ndaj ankuesit, ky i fundit përveç pohimit, nuk ka bashkëngjitur prova me të cilën do vërtetohej se N.Hh-ja i ka mbetur borxh atij. Për më tepër ankuesi nuk ka dorëzuar ndonjë specifikacion se për cilët muaj i kërkon pagat, ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi lidhur me lartësinë dhe llogaritjen e pagave të kërkuara. Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për 3 paga të pa paguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Kopja e vendimit të atakuar të Autoritetit të Likuidimit, Parashtrës drejtuar AKP dt.07.03.2011, Vërtetimi nr.374 dt.25.02.2011, Vendimi nr.760/3 dt.03.12.2003, Njoftimi nr.0400/IN dt.08.03.2011, Njoftimi nr.0428/2011 dt.14.03.2011, Kopja e padisë SCC-11/98 dt.17.03.2011, nuk dëshmojnë se N.SH ia ka mbetur borxh ankuesit paga të pa paguara.

Gjykata i dha mundësin ankuesit përmes dërgimit të mbrojtjes, që ti paraqes pretendimet e tij, ku do të mund të bashkëngjiste prova konkrete me të cilat do të dëshmonte se vërtet ka ofruar shërbime për NSH-në, ashtu të dëshmonte se NSH i ka mbetur borxh tri paga të pa paguara për këtë periudhë, por ankuesi dështoj që ti dëshmonte këto pretendime, andaj gjykata vendosi që ankesën e tij ta refuzoj si të pa bazuar.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë i bartë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, ankuesi është i liruar nga pagimi i taksës gjyqësore meqë vlera e kontestit nuk e kalon vlerën mbi 1000 €.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gj y q t a r i
Shkelzen Sylaj